



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MIRËQENIES  
SOCIALE DHE RINISË  
MINISTRI

**Përschëndetja e Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë  
në përvjetorin e 25 -të krijimit të  
Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë**

I nderuar Presidenti Nikollaj,

Të nderuar anëtarë të Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë,

Ju falenderoj për ftesën në këtë përvjetor të njëqerek shekulli jete dhe aktivitet. Dëshëroj t'ju shpreh konsideratën time më të lartë për rolin aktiv që ka pasur KSSH në zhvillimin e dialogut social në Shqipëri, si faktor i pajtimit të interesave, i konsensusit social trepalesh.

Puna dhe përpjekjet tuaja në zhvillimin e dialogut social konstruktiv, nëpërmjet rritjes së kontraktimit kolektiv dhe përmirësimit të vazhdueshëm të performancës së këtij procesi në plotësim të interesave tuaja legjitime, kanë gjetur dhe do të gjejnë mbështetjen e Qeverisë Shqiptare në përgjithësi dhe Ministrisë që unë drejtoj, në veçanti.

Duke e cilësuar si një ngjarje të veçantë, ju përschendes edhe në emër të Qeverisë Shqiptare dhe Kryeministrit, Zotit Edi Rama, i cili ju uron një përvjetor të veçantë, të gëzuar dhe pikënisje për hapësira dhe strategji të reja për një Shqipëri Europiane.

Duke përfituar nga rasti, dëshëroj të ritheksoj angazhimin serioz të Qeverisë shqiptare për zbatimin me sukses të përgjegjësisë kushtetuese, politike, ekonomike dhe sociale që ajo ka ndërmarrë në zbatim të Programit të saj qeverisës dhe integruës.

Qeveria shqiptare ka kërkuar dhe mirëpritur rolin dhe kontributin e të gjithë aktorëve të shoqërisë shqiptare për përballimin me sukses të këtyre përgjegjësisë, ku vendi dhe roli i Sindikatave në Shqipëri mbetet i pazëvendësueshëm.

Sindikatat kanë pasur një angazhim serioz në të gjitha reformat e ndërmarra, si: Ndryshimet në Kodin e Punës, reformën e pensioneve, strategjinë kombëtare të punësimit dhe aftësive, aksionin për luftën ndaj informalitetit, nxitjen e punësimit dhe përhapjen e kulturës së punës se denje, dokumentin politik të sigurisë dhe shëndetit në punë, etj.

Dua te falenderoj në menyërë të veçantë antarët e KKP të KSSH për kontributin e tyre konstruktiv, për pjesëmarrjen aktive në dialog, për konsensusin e dhenë për të gjitha nismat ligjore që kemi paraqitur ne Kuvend. Asnje projektligj, i iniciuar nga MMSR, nuk ka shkuar në Kuvend pa miratimin në KKP.

Është bërë tashmë traditë e bukur, që ndërsa vitet kalojnë të mblidhemi për të përkujtuar krijimin e organizatave të para sindikale, ashtu si përkujtojmë fillimin e viteve '90, që sollën shndërrimet e mëdha ekonomike e sociale në vend, që shenjuan perspektivat e themelimit të një shoqërie demokratike në Shqipëri.

Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë, të cilën shpesh e perifrazojmë si KSSH është një nga partnerët e njohur dhe të vlerësuar për veprimtarinë e zhvilluar në aspektin territorial dhe strukturor, madje nuk do të druhesha ta cilësoja si avangardën strukturore të organizatave punëmarrëse në Shqipëri.

Për këto arsye, natyrshëm KSSH është nga anëtarët me kontributive qysh në themelimin e Këshillit Kombëtar të Punës dhe të Këshillave Administrative trepalesh në të gjitha Institucionet tona.

Gjatë kësaj periudhe KSSH ka qenë jo vetëm nismëtare për të rritur bashkëpunimin me qeverinë në nivel qendror, por edhe për të siguruar mirëkuptim dhe zgjidhje paqësore të mosmarrëveshjeve kolektive të punës në nivel ndërmarrjeje dhe sektori, ndërmjet federatave dhe punëdhënësve qofshin këta publikë apo privatë.

Në këtë kontekst, angazhimet dhe përpjekjet e përbashkëta për përmirësimin e sistemit të dialogut dhe partneritetit social janë në harmoni të plotë me synimin dhe objektivat e Qeverisë për forcimin e kohezionit social, garantimin e një zhvillimi të qendrueshëm ekonomik, përmirësimin e nivelit të jetesës dhe kryerjes me sukses të reformave standarde në plotësimin e kushteve dhe kërkesave për anëtarësimin e vendit tonë në Bashkimin Europian.

Qeveria synon që objektivat madhore për zhvillimin ekonomik, shoqëror dhe integrimin e vendit, t'i realizojë nëpërmjet një procesi përfshirës, pjesëmarrës dhe një konsensusi sa me të gjerë shoqëror dhe politik. Mirëkuptimi i gjithë aktorëve dhe faktorëve socialë dhe angazhimi i tyre për të njohur e pranuar, krahas të drejtave, edhe detyrimet, vështirësitë dhe pasojat e natyrshme të proceve reformuese dhe integruese, është një tregues i vetëdijes kombëtare.

Mund ta shpreh me bindje konsideratën, se KSSH ka qasjen dhe staturën për të qenë përkrah qeverisjes se mire, si dhe forcën oponente për të vepruar në interes të grupit të interesave që ajo përfaqëson, brenda kufijve që jep ligji.

Në përfundim, më lejoni edhe njëherë t'i uroj gëzuar përvjetorin tuaj të 25-të, duke ju siguruar për vullnetin dhe angazhimin e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë në forcimin e bashkëpunimit dhe asistencën për një dialog social të qendrueshëm dhe partneritetit real.

Ljuaji

Blendi Klosi

